



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL IV /2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 4 (katërt) për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 29.04.2025
Ora: 10:00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyçi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj.Jehona Lumi
Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024 ,të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve nga fondi rezervë në projekte kapitale për vitin 2025;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme;**
- 7. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2025;**
- 8. Njoftim i Mekanizmit kundër dhunës në familje;**
- 9. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe propozon një pikë shtesë në rend dite e cila ka të bëjë me një kërkesë për ndihmë materiale.Bëhet fjalë për veteranin e luftës Lum Haxhiun nga Samadraxha të cilit nga erërat e forta iu ka heq komplet kulmi i shtëpisë.Ju kërkoj me mirëkuptim që ta fusim si pikë shtesë dhe ta ndihmojmë veteranin e luftës dhe ti ndajmë mjete materiale në shumë rreth 5.000€.E hedh në votim pikën shtesë për rend dite.

Unanimisht Miratohet pika shtesë

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit.Në bazë të nenit 47,ligjit për vetqeverisje lokale pika 47.2 e cila na mundëson që të propozojmë pikë shtesë për rend dite,në emër të grupit të asambleistëve të PDK-së kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit të hudhet në votim propozimi për pikën shtesë të rendit të ditës që,që nga viti fiskal 2026 të lirohen të gjitha bizneset nga taksa e aktiviteteve biznesore.Sa i përket çështjes ligjore dhe përgaditjes së projekt-vendimit ne e dimë që i takon ekzekutivit,Drejtorisë së Financave dhe Zyrës Ligjore.E di që edhe kolegët tjerë e kanë kërku muaj më parë dhe kërkoj që të futet në votim për diskutim.

Liridon Fandaj - përshëndet të pranishmit.Ne i kemi mbështet gjithmonë iniciativat për ndihmë të biznesit por arsyetimi i Dardanit është i paqartë.Nëse ka ndonjë fatkeqësi ose diçka ne mundemi me i ndihmu bizneset por për deri sa e kemi bënë një rregullore dhe sponzorues është Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave ku është pjesë e PDK-së,është shumë e paarsyeshme.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit.Besoj që të gjithë e dini që iniciativa për këtë projekt-vendim që sapo është propozu ka qenë e Dr.Shefketit e pastaj e edhe e jona si grup dhe dy herë ne e kemi propozu dhe nuk ka kalu.Sot po na vjen një propozim nga PDK-ja që për aq sa unë di,atëherë projektvendimin

tonë e kanë votu kundër dhe ky reflektim i PDK-së me një anë më duket i mirë sepse ne atëherë e kemi mbështet Dr.Shefketit dhe e mbështesim edhe tash këtë projekt-vendim.

Dardan Berisha - unë e kam propozu vetëm me shqyrtu dhe nuk është projektvendim sepse ne mund të përgaditim projekt-vendim prej Kuvendit.Konkretisht i takon Drejtorisë së Financave,ekzekutivit dhe zyrës ligjore me përgadit projektvendimin.Ne e dimë që vitin e kaluar e kemi heq tatimin në pronë kush i ka mbi 100€ dhe kjo ka qenë ndoshta arsya pse ne nuk e kemi përkrah.Unë mendoj që kjo është urgjente për të gjithë aktivitetet që bizneset i kanë,ngritjes së çmimit të rrymës dhe mbi të gjitha në bashkëpunim edhe me shoqatën e bizneseve është prioritet për të gjitha bizneset që të hiqet taksa komunale biznesore dhe kjo pikë është propozim për diskutim.

Aziz Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Kërkesa e Dardanit është që ta diskutojmë dhe ne nuk kemi asgjë kundër.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë për diskutim.

22 për, 4 apstenime, Miratohet pika shtesë

Armend Krasniqi - përshëndet të pranishmit.Pasi kemi përfunduar të gjitha procedurat në lidhje me një konkurim të hapur,me 29.04.2025 komisioni përkatës i ka përfunduar të gjitha procedurat andaj propozojmë që Asamblea të miratoj raportin apo vendimin të cilin e kemi sjell në Asamblenë komunale në mënyrë që të përfundoj si procedurë sepse ministria po i vonon vendimet 30 ditë,andaj kërkoj nga asamblea komunale që mos ti humbim kohë edhe komunës dhe biznesit përkatës që e ka marrë këtë parcelë.Drejtori tutje jep sqarime.

Kryesuesi - jep sqarime se pse ka ardhë kjo pikë.

Laureta Tafaj - përshëndet të pranishmit.Drejtori si çdo muaj vjen me vetëbesim të plotë dhe na sjell një vendim.Drejtor,nuk mundemi ne për gjysmë ore me votu diçka që ti ke mendu,e ne nuk dimë kurgja në atë aspekt.Të lutem leje ni muaj kohë të paktën ne me mendu se çka dojmë me votu.

Alban Berisha - përshëndet të pranishmit.Kam vërejtje për drejtorin.Drejtor,janë procedura administrative që duhet m'u përfundu dhe është normale që këto pika vinë edhe në seanca të jashtëzakonshme por të paktën ta sillnit një dokument sepse nuk është problem të bëhet një kopje.

Duhet të hiqet kjo logjikë sepse vërejtjet e nejta i ke gjithmonë.

Armend Krasniqi - në nëntor është marrë vendimi për me inicu si procedurë dhe para 4 apo 5 ditëve ka përfundu afati i ankesave dhe në momentin e përfundimit të ankesave ne mundemi me dërgu një raport te zyra e Kryetarit ku zyra e Kryetarit i propozon Asamblesë Komunale për me vazhdu tutje.

Alban Berisha - në rregull është por dil në vendin tonë njëherë.Çka ka të keqe prej teje nëse s'ke arrit me dërgu një email,ku lejohet me na dërgu email paraprakisht.Sot para seancës është dasht me na sjell nga një kopje dhe do ta dinim çka kemi me votu.Është edhe fyerje e karakterit dhe pozicionit tonë me thënë: ne e propozojmë dhe votohet.Të lutem të jetë hera e fundit sepse edhe me qenë në interesin e qytetarëve më nuk e votoj.

Kushtrim Kuçi - përshëndet të pranishmit.Unë e kuptoj Albanin dhe ka të drejtë mirëpo nuk e kuptojnë dinamikën e punëve në ndërtim që e kemi pa si komision e që një muaj është shumë.P.sh. nëse nuk kalon sot,pas një muaji ka me kalu.Ne jemi me arsyetu punën tonë dhe me i shërby qytetarëve dhe më mirë le të kryhet sot se pas dy muajsh.Sot ne komisioni prej 5 anëtarëve kemi shku në komunë në 7 mëngjes për ti përfundu punët si komision vetëm që mos të vonohet procedura.

Urim Suka - unë e kuptoj Kushtrimin dhe në parim Kushtrimi e ka mirë dhe ne jemi për m'i mbrojtë interesat e qytetarëve.Mirëpo për shkak të një papërgjegjësie të drejtorit si kryetar i komisionit po kërkohet sot me hy një pikë në rend të ditës,raporti i komisionit.A kemi me votu raportin apo ka me na ardhë një projektvendim?me ditë çka kemi me votu.Unë mendoj që është e papërgaditur për me ardhë këtu dhe nuk është problemi që ne nuk duam sepse edhe ne duam ta shtyejmë përpara por çka me shty përpara,këtë raport apo një projektvendim që duhet me na ardhë? Nuk është përgjegjësi e Kushtrimit por është përgjegjësi e kryetarit të komisionit me thirr komisionin me kohë.

Liridon Fandaj - drejtor,raportet tjera që i ke sjell këtu kanë qenë anëtarët e komisionit.Në këtë raport kush e ka bërë vlerësimin?Këtu nuk po e shoh asnjë anëtar të komisionit.Ndoshta zyrtari ligjor na sqaron se a ka të drejtë vetëm me një konkurent me vazhdu kjo si raport dhe si vendim me u bë.

Armend Krasniqi - çdo konkurim i hpur është një procedurë në vete. Drejtori jep sqarime sa i përket gjithë procedurës që ka ardhë deri këtu kjo pikë.

Kryesuesi - zyrtari ligjor thotë që ka të drejtë me shku me një ofertues.

Saranda Bajraktari - përshëndet të pranishmit.Edhe kryetari i komisionit dhe ne si anëtar të komisionit kemi punu me përgjegjësi për shkak se kanë qenë procedurat ligjore të cilat duhet me u respektu,çoftë afati i prokurimit që ka qenë 15 ditë,afati i ankesave dhe ky raport bazohet me projektvendimin që ka me u bë.Nuk është mospërgjegjësi për shkak se në këtë rast kryetari i komisionit nënshkruan por komisioni ka qenë i përbërë prej anëtarëve të kuvendit që edhe është votu.

Kryesuesi - e hedh në votim kërkesën për rend dite për vlerësimin dhe rekomandimin e raportit të komisionit.

17 për, 4 kundër, 6 apstenime, Miratohet pika shtesë

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me tri pikat shtesë.

16 për, 5 kundër, 8 apstenime, Miratohet rendi i ditës

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe kërkon nga subjektet politike ti japin propozimet e tyre për anëtar të komisionit.

Aziz Bytyqi - ne propozojmë Saranda Bajraktari.

Selman Kolgeci - ne emër të grupit të LDK-së propozojmë Bulëza Kuçi.

Dardan Berisha - PDK propozon Bajram Bashën.

Laureta Tafaj - ne nuk kemi propozim.

Jehona Rrafshi Lumi - NISMA nuk ka propozim.

Herolind Limaj - nuk kemi propozim.

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Saranda Bajraktarin.

17 për,3 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Bulëza Kuçin.

14 për,12 apstenime

Kryesuesi - e hedh në votim propozimin për Bjaram Bashën.

16 për,1 kundër,8 apstenime

Kryesuesi konstaton që Saranda Bajraktari dhe Bajram Basha janë pjesë e komisionit.

Kryesuesi - kërkon propozimet nga ekzekutivi.

Kryetari - propozoj Armend Krasniqi, Visar Kuçi dhe Suzana Gashi.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Saranda Bajraktari, Bajram Basha, Armend Krasniqi, Visar Kuçi dhe Suzana Gashi.

17 për, 1 kundër, 9 apstenime, Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin fiskal 2024 ,të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - lidhur me këtë vendim, ju Kryesues e thatë edhe vet që ky vendim është marrë muajin janar mirëpo për shkak që është kthyer nga ministria në detyrohemi tash me marrë një projektvendim të ri. Në seancën e kaluar ju keni provu përmes një sqarimi me kalu atë dhe e keni kuptu që duhet me ardhë një projektvendim i ri dhe unë atëherë pata një diskutim ku, nëse ka ra projektvendimi paraprak, duhet m'u marrë projektvendim i ri dhe me ardhë në seancë të rregullt. Atëherë zyrtari ligjor ka thënë që nuk ka ardhë një shkresë, vendimi paraprak nuk është shfuqizuar. A po i bie që ne me këtë projektvendim që po e marrim, e kthejmë atë që kemi thënë në muajin e kaluar, që vendimi paraprak po shfuqizohet dhe po e bëhet një projektvendim i ri. A duhet me dhënë dikush përgjegjësi pse po vijmë deri në këtë situatë?

Kryesuesi - faktikisht neve nuk na ka ardhë shkresë prej ministrisë që vendimi kthehet mirëpo duhet vetëm me u dhënë pjesa e arsyeshmërisë se ku do të barten mjetet. E hedh në votim pikën 3.

15 për, 3 kundër, 7 apstenime, Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e mjeteve nga fondi rezervë në projekte kapitale për vitin 2025;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - këto mjete a janë të dedikuara për blerjen e fshesës për pastrim të rrugëve dhe trotuareve edhe pse nuk na lejon ligji me qu në Eko Therandë apo do të përdoren për nevoja komunale edhe për projekte tjera?

Kryesuesi - besoj këto kanë me u përdor edhe për nevoja tjera.

Liridon Fanda - nëse këto mjete na vijnë në vendim për paisje, duhet të dedikohen për paisje, jo për paga të Eko Therandës.

Kryetari - nuk është vetëm një paisje por kanë me u ble shumë paisje. Nuk shkojnë për paga.

Liridon Fandaj - atëherë duhet të specifikohen për çka konkretisht.

Kryetari - jemi këshillu me Ministrinë e Financave dhe kështu na kanë thënë.

Dardan Berisha - përveq asaj që tha Liridooni, në KPF është thënë diçka tjetër dhe këtu po thuhet diçka tjetër dhe përgjigja ka qenë që këto mjete mundën m'u bartë dhe m'u transferu për t'u përdor për mallra dhe shërbime. Ka po shkon destinimi i kompanisë "Eko Theranda"? Ne kur e kemi marrë vendimin e formimit të kësaj kompanie, ajo ka qenë për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve dhe gjithçka çka i përket qytetit. Ne nuk kemi votu projektvendim që ka m'u marrë me pastrimin e qytetit dhe as me grumbullimin e mbeturinave dhe realisht qysh po e shoh unë, kjo kompani kahjen dhe destinimin po e merr kah Eko Regjioni.

Kryetari - nuk ka të bëjë asgjë me Eko Regjionin. Është kompani komunale. Do të merret me gropa, me banesa, me mirëmbajtje, me ndriçim dhe shumë punë tjera.

Urim Suka - ka qenë edhe kërkesë e jona që një kompani komunale të themelohet dhe jemi të lumtur që Ministria e ka dhënë pëlqimin që kjo kompani të themelohet. Kompania është në fazën fillestare dhe i duhet mbështetje. Duke marrë për bazë që këto mjete janë klasifiku si mjete në fondin rezerve dhe nëse i lëmë aty, ne nuk mund ti përdorim, ne mendojmë që këto mjete duhet të barten dhe të kalojnë për çka po destinohen dhe me idenë që këto mjete kanë me shku për Eko Terandën. Shqetësimet që kanë asambleistat

tjerë për mënyrën se si do të menaxhohen këto mjete, për mënyrën se si po destinohen dhe ka do të shkojnë këto mjete, i kemi edhe ne siç i kemi për çdo shpenzim që bëni ju si ekzekutiv mirëpo ne do ti japim mbështetje këtij projektvendimi fillestar e mandej do të shohim se si janë shpenzuar këto mjete të cilat po i miratojmë ne sot.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

20 për, 3 apstenime, Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - në dukje ky vendim dhe kjo nismë është jashzakonisht e mirë sidomos për ata që nuk kanë njohuri se çka në të vërtetë ka në Agrozonë dhe çka vërtetë fshihet pas këtij tentimi për ta arsyetuar dështimin e kësaj qeverisje për të funksionalizuar Zonën Ekonomike të premtuar nga vet Kryetari. Kjo nismë është vendim elektoral dhe për të joshur ndonjë biznes dhe qytetar me ato parcela atje. Arsya pse unë mendoj që këto janë akrobacione për përfitime elektorale është se ne në këtë kuvend kemi diskutu disa herë për neglizhencën që ky pushtet ka treguar në atë agrozonë. Po ashtu vërejtjet e mia kanë qenë se si mendohet të funksionalizohet ajo zonë ku asaj zone i mungojnë elementet bazike që një biznes mundet me operu aty. I keni pas 8 vite kohë për me investu dhe për ti dhënë formën e një agrozone që bizneset mund ta shfrytëzojnë. A janë këto parcella në listen e parcellave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim? Këtij vendimin ne kemi me i dhënë mbështetje për shkak se vendi ka nevojë me u zhvillu dhe bizneset kanë nevojë me u funksionalizu në atë zonë mirëpo ti në këtë fazë po e bën për qëllime elektorale.

Kryetari - ne po e kryejmë si obligim ligjor që e kemi. Qëllimi është që ato prona me i marrë dikush, kush don me punu dhe ju e dini që vitin e kaluar i kemi shfuqizu 15 vendime aty që e kanë marrë njerëz dhe nuk kanë punu.

Armend Krasniqi - sa i përket inicimit të kësaj procedure për dhënie në shfrytëzim të pronave afatgjate, kjo procedurë është nisur nga Drejtoria ime. Është nis si procedurë vetëm me funksionalizu si zonë e cila konsiderohet e dështuar ndërsa sa i përket infrastrukturës nuk është krejt terr, ka pak kanalizim, ka ujë dhe ka rrymë mirëpo siq kam dëgjuar, trafën e ka vjedh dikush. Besoj shpejt kanë me vendos trafën. Patjetër që çdo prone që vjen në Asamblenë komunale, është publikuar në listen e veçantë dhe në listen e përgjithshme të pronave sipas ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronave komunale.

Selman Kolgeci - po e pranoni edhe ju si anëtar i kësaj keqqeverisje që ajo zonë është zonë e dështuar dhe po e pranoni edhe Kryetari që kanë nënshkru kontrata me operatorët ekonomikë dhe janë detyru m'i shkëput ato kontrata për shkak të mungesës së investimeve aty. Sa i përket përgjigjes së drejtorit, drejtor ne e patëm parcellën dhe na u kthi prej ministrisë për arsye se nuk ka qenë në listen e parcellave që kanë me u dhënë në shfrytëzim, ka edhe raste tjera.

Liridon Fandaj - për me njoftu kolegun Selman që kjo është propagandë, e ka thënë vet drejtori në KPF që kjo është propagandë sepse këto parcela nuk i plotësojnë kushtet për me i dhënë. Prodhimi i mishit të viqit dhe të pulës paraprakisht duhet me pas një pëlqim prej agjensionit të veterinarisë dhe ushqimit. Ti këtë pëlqim nuk e ke dhe çka ndodh nëse operatori ekonomikë e merr këtë dhe dështon mos me marrë atë pëlqim? Është dasht me i analizu këto parcella dhe veprimtaritë sepse aty nuk i plotësojnë kushtet gjysma prej këtyre veprimatrive që i ke këtu.

Armend Krasniqi - sa i përket agrozonës ne e kemi inicuar një procedurë në formë të rregullt. Opozita detyrën e ka me sulmu mirëpo nuk sulmohet një vendim që është i jashtëzakonshëm i cili është në të mirën dhe interesin e qytetarëve ku munden me u zhvillu biznese të mira sepse interesi është mjaft i madh dhe kërkoj nga ana juaj që të mbështeten të gjitha vendimet e mira që vijnë nga drejtoria apo komuna.

Liridon Fandaj - për punën e propagandës e thashë vetëm atë që e ke thënë në KPF. Prodhimi i mishit të viqit dhe të pulës, nëse një operator aplikon dhe e merr këtë, kush ja siguron lejen që aty nuk i plotëson kushtet për ta zhvilluar këtë veprimtari?

Armend Krasniqi - përveq planit rregullues ne e kemi edhe HZK-në.Në HZK kemi parapa edhe destinime tjera të cilat mund ti përshtaten agrozonës dhe mund të bëjmë ndryshime përmes komisionit i cili do të formohet në këtë Asamble dhe mund të marrësh pjesë edhe ti.

Urim Suka - mendoj që ne minimalisht duhet të sillemi serioz në selin vendim që marrim e sidomos kur jemi te vendimi në fjalë për Agrozonën.Ne jemi në vitin e fundit të një 8 vjeqari të qeverisjes tuaj dhe në atë Agrozonë mungojnë kushtet elementare për me zhvillu një biznes aty dhe ky pushtet nuk ka arrit me kriju deri tash as infrastrukturën minimale për me zhvillu atë zonë.Në praktikën e drejtorisë e juve si pushtet deri tash na keni sjell vendime individuale për parcella individuale,varësisht prej kërkesave që keni marrë deri tash.Kur jemi tash,pak para zgjedhjeve,ju e keni sjell një projektvendim ku mendoni për kreu parcellat me i dhënë menjëherë në shfrytëzim.Në plan të parë edhe ne jemi për me zhvillu atë zonë dhe deshëm ta mbështesim por kur i analizon kreu këto,përfundimisht po vim gati në fundin që nuk po dojna me i plotësu apetitet e juaja për qëllime politike për pushtet por duam ti themi stop një projektvendimi të tillë dhe menjëherë me qeverisjen e re që besoj po vjen,me fillu me zhvillu infrastrukturën në këtë zonë dhe me i dhënë parcellat në shfrytëzim për njerëzit që janë të intereasuar me zhvillu aktivitetin atje,madje brenda mundësive m'i dhënë mbështetje projekteve që janë zhvillimore për Agrozonë.Pas konsultimeve edhe pse e patëm vullnetin me mbështet,ne nuk i japim mbështetje në këtë formë si e keni sjell këtë projektvendim.

Armend Krasniqi - nëse një asambleist,shef i grupit 4 vjet thotë që ju e keni nis për m'i premtu dikujt,kjo është qasje e gabueshme.Ne po veprojmë ligjerisht për dhënien e parcellave ku në kuadër të ligjit po i fusim anëtar të komisionit edhe LDK-në dhe të thotë një anëtar i LDK-së që ne i kemi dhënë dikujt një parcellë që s'e ka meritë.

Urim Suka - ky foli tjetër gjë dhe jo nga ajo që thash unë.8 vjet i ke pas për me zhvillu atë zonë,nuk e ke zhvillu dhe ke ardhë në fund dhe i ke vendos kreu përnjëherë.Për shkak të kësaj ne jemi kundër.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

13 për, 11 kundër, Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - edhe në KPF e kam pyet drejtorin se a ka licencë ky operator dhe ky më ka thënë po por unë e di që të gjitha licencat për gurëthyes janë revoku.Nuk e di si do ta japim ne një pronë kur nuk i lejohet veprimtaria.

Armend Krasniqi - disa herë e kam përsëritur që DSHPJ punon vetëm sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.Në HZK një parcellë e kemi parapa që është destinimi i saktë gurëthyes ndërsa operatori i cili ka bërë kërkesën i ka paraqit edhe shumë më shumë dokumenta shtesë se sa kërkohen dhe ne kemi vendosur që ta inicojmë si procedurë por nuk do të thotë që e ka paraqitur ai,e merr ai.Ia japim atij i cili i plotëson kriteret që i parashtron komisioni i cili formohet në Asamblenë komunale.

Liridon Fandaj - unë pyeta për lejen që ministria e lëshon për veprimtaritë,sa ka afat?

Armend Krasniqi - deri në 2031-tën.

Liridon Fandaj - a është duke funksionu ndonjë gurëthyes në komunën tonë?

Armend Krasniqi - aty nuk është duke funksionuar ai gurëthyes saktësisht mirëpo gurthyes që janë duke funksionu në komunën tonë janë 5 dhe kanë pëlqim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6 që të jepet në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite.

22 për, 3 kundër, Miratohet pika 6.

Pika7. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-mars 2025;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - pas analizës së raportit për ekzekutimin e buxhetit të K.Suharekës për periudhën janar-mars 2025 po paraqes disa vërejtje: 1.shpenzimi i ulët i buxhetit të alokuar sidomos për projektet kapitale.Nga 5.200.000€ të alokuara për projekte kapitale,janë shpenzuar vetëm 550.000€,nga to 10.65 % nga Granti Qeveritar dhe 0% nga të hyrat vetanake.Projekte të shumta kanë mbetur pa u prekur fare çka tregon për ngecje në realizim të projekteve fizike në teren.Realizimi i dobët i të hyrave vetanake ku janë realizuar 86.42% e planifikimit për këtë periudhë ku për 81.000€ janë më të ulëta në periudhën e viti 2024.Tatimi në pronë është realizuar vetëm 53.79% krahasuar me planin dhe është një tregues i menaxhimit të dobët të arkëtimit të të ardhurave tatimore.Shpenzime të ulëta në disa drejtori të rëndësishme.DSHPE ka shpenzuar 5.95%,DBZHRP vetëm 1.72%.Këto përqindje të ulëta mund të ndikojnë negativisht në shërbimin e qytetarëve dhe në zhvillimin rural.Përqindja e lartë e buxhetit në paga ku 68.65% ka shku vetëm në paga dhe meditje.Teprica buxhetore për periudhën e ardhshme tre mujore arrin në vlerën 8.000.000€.Kjo është një mungesë e transparencës dhe arsyes së mos realizimit të projekteve kapitale.

Urim Suka - raporti tremujor është obligim që ekzekutivi ka m'i paraqit Asamblesë çdo tre muaj dhe në kuadër të kësaj ka ardhë ky raport ku unë kam bërë përpjekjen me analizu dhe disa informata që i kam pa nga ky raport dua ti ndaj me ju.Kur e sheh këtë raport dhe kur e analizon atë çka ka ndodh vitin e kaluar,ti e sheh që komuna ballafaqohet me probleme të mëdhaja për shkak edhe të përmbaruesve por problemet janë pastaj që ekzekutivi i krijon edhe problemet tjera shtesë për shkak se nuk i përcjell projektet që kanë dështu të realizohen vitin paraprak,nuk i përcjell në vitin vijues në planifikimet e ardhshme dhe kjo po krijon vështitësi të mëdhaja në implementimin e buxhetit dhe për realizimin e projektev që janë me inters për qytetarët.Ndërtimi i zonave infrastrukturore smart po figuron që janë shpenzu 50.000€ dhe unë nuk di që në qytet është investu te zonat smart.Ndërtimi i pullazit në stadiumin e qytetit në Suharekë po figuron që janë shpenzu 195.000€ dhe unë çdo ditë jam te satdiumi i qytetit,nuk ka ndodh asgjë aty.Ndërtimi i sallës sportive në shfmu "Dëshmorët e Tivarit" në Peqan figuron që janë të shpenzuara 78.000€ dhe sipas informatës që kam nuk ka ndodh investim aty.Ndërtimi i aneksit në shkollën "Rilindja" në Njëpërbisht 120.000€ figurojnë të shpenzuara aty mirëpo nuk ka fillu investimi atje.Kur i mora këto informata unë isha i vetëdijshëm që vërtetë ju s'i keni shpenzu në atë formë dhe pastaj u informova që këto mjete i ka marrë përmbaruesi.Kur i heq këto që sapo i përmenda,krejt projektet tjera e kanë zero investimin për këto tre muaj.Unë i kuptoj vështirësitë për tremujorin por nuk i kuptoj vështirësitë te projektet që janë dy vjeqare.Dua të ju them juve që ju ta keni të paktën parasysh që nëse sot këto projekte dështojnë sivjet,me qenë në planifikim të vitit të kaluar sepse përmenda rrugët në Suharekë ku kanë dështu m'u realizu në atë vit dhe nuk janë as në planifikim këtë vit.Pyetja ime është:çka do të ndodh me mbulojën te stadioni?A do të realizohet apo jo?Çka do të ndodh me aneksin e shkollës në Njëpërbisht?A do ta filloni apo jo?A do të filloj apo jo projekti i sallës në Peqan?Kërkoj nga ju që nëse nuk i relizoni tash, ju duhet ti bartni vitin tjetër këto projekte. 1.236 € figuron shpenzimi i telefonisë mobile në zyrën e Kryetarit dhe në KPF thanë që është për të gjitha drejtoritë dhe kur e pash raportin e pash që figurojnë mjete të shpenzune edhe nëpër drejtori për telefoni mobile.Nëse këto para janë të shpenzuara vetëm te zyra e Kryetarit,mua më duken tepër.Kompenzimi i përfaqësimit brenda vendit 3.400€,shpenzim te zyra e Kryetarit.Kërkoj sqarime se ku kanë shku këto 3.400€.

Labinot Halitjaha - përshëndet të pranishmit.Buxheti i Komunës së Suharekës për vitin 2025 është 23.000.000€.Janë alokuar nga buxheti i Kosovës 11.177.000€ ndërsa nga vetanakët janë alokuar 465.000€ dhe të shpenzuara janë 518.000 nga të hyrat vetanake ndërsa nga tërë buxheti për tremujorëshin janë 4.421.679 ,në vlerë 35 %.Është e vërtetë që kemi pas disa probleme të vogla sidomos me pjesën e përmbaruesit ku e cekë që vendimet gjyqësore kanë marrë disa të holla nga buxheti komunal.Kjo çështje është në gjithë Kosovën dhe jo vetëm në komunën tonë.Liridoni tha që buxheti është shpenzu pak dhe të hyrat janë të vogla.Çdo vit të hyrat në fillim të vitit gjithmonë janë më të vogla dhe gjatë kohës,sidomos prillit e mbrapa fillojnë të hyrat dhe fillojnë edhe punimet në komunë.Sa i përket shpenzimeve që cekë Urimi,për secilën drejtori janë të sqaruara shpenzimet dhe nëse ke diçka konkrete është mirë t'i drejtohesh secilës drejtori sepse ata e dinë më mirë secili për shpenzimin e vet që ka ndodh. Përmbaruesi në periudhën janar-mars në K.Suharekës i ka marrë me vendime gjyqësore te mallra dhe shërbime 99.655€,

te subvencionet i ka marrë 87.344€ dhe te investimet kapitale 508.000€.Për projektet kapitale që the që janë marrë të hollat dhe çka do të bëni me to,ne kemi me kërkë të hyrat vetanake nëse mundemi me i rrit dhe me bë në qershor ose në pjesën e fundvitit,pjesën e të hyrave vetanake me rialoku ose tepricën prej pjesëve tjera mundemi me i bartë me vendime të Kryetarit për punimet tjera.Këto janë mundësit tona.

Urim Suka - unë e lus drejtorin që në raportet tjera kur të vijnë,të paktën le të figuron te raporti që kaq mjete prej investimeve kapitale janë marrë prej përmbaruesve.

Liridon Fandaj - drejtor i kuptoj kushtet atmosferike por disa drejtori nuk i ka pengë kushtet atmosferike por është mospuna e drejtorëve për me i zhvillu këto investime që janë parapa në buxhet.Të paktën nëse është një informatë,në fund të tabelave shkruar që për shkak të kushteve atmosferike nuk është përfunduar.

Te pjesa tjetër e investimeve kapitale që i ceki Urimi,të paktën nëse i ka marrë përmbaruesi edhe kjo si informatë që na vje neve në Asamble,duhet me ditë se ku kanë shku ato mjete.Nëse i ka marrë përmbaruesi,duhet ta shkruar që i ka marrë përmbaruesi dhe jo me vendos si investim i përfunduar.

Fadil Hoxha - Liridoni tha që projektet kapitale janë aloku 5.300.000 dhe janë shpenzu 555.000.Po ju tregoj që alokimet bëhen në fillim të vitit kurse rregullorja 01/2022 mbi rrjedhën e parasë dhe menaxhimin i ndan me pjesë për çdo muaj aq sa është pjesa e planit,që llogaritet që ka me u shpenzu.Urimi tha që projektet janë zero por po ju them që nuk janë zero por janë dy projekte që janë bë shpenzim.Është një projekt 57.078 te DSHPE dhe një projekt te QKMF-ja 31.576.Thatë që nuk kemi informacion për vendimet e gjykatave dhe këtu janë disa prej atyre projekteve që përmendi Urimi që është e vërtetë që i kanë heq vendimi i gjykatave te: Ndërtimi i smart zonave nëpër hapësira,Ndërtimi i pullazit në stadiumin e qytetit,Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Mushtisht dhe Ndërtimi i sallës sportive “Dëshmorët e Tivarit” në Peqan.ZKF jep sqarime sa i përket vendimeve gjyqësore te secila drejtori dhe thotë që janë në material. Sa i përket shpenzimit te zyra e Kryetarit për kompenzim i përfaqësimit brenda vendit,kodi është i njëjtë por e kanë ndërru emrin sepse realisht është dreka dhe darka te zyra e Kryetarit.Pra te secila drejtori që e shihni që është kompenzim i përfaqësimit brenda vendit,janë dreka dhe darka.

Liridon Fandaj - te shpenzimet kapitale 5.2 milion të alokuara,unë nuk e di si alokohen mjetet pa planifikim.Nëse ti thua që neve na kanë aloku mjetet,ato janë në bazë të planifikimit tuaj dhe mos realizimi është kjo që prej 5.2 milionëve vetëm 10.65 % janë shpenzu.Te vendimet gjyqësore,nuk prish punë me shkru:vendime gjyqësore të marrura nga ky projekt sepse te projektet kapitale nuk është që nuk i kemi pa sepse nuk jemi aq naiv por duhet me specifikë ose me dhënë një arsytim se pse nuk janë bë ato.

Fadil Hoxha - kodi është 34000 vendime gjyqësore dhe unë nuk mund të shkruaj çka të dua por me atë kod jam i obliguar me i vendos.Në vendimet gjyqësore të tjera,me emër e ke listen e projekteve kapitale.

Liridon Fandaj - e kuptoj por te ato drejtori nuk të pengon ty nëse ma jep këtë informatë.Te 5.2 milion që e thash,ata nuk t'i alokojnë mjetet pa alokim.

Fadil Hoxha - ZKF jep sqarime.

Urim Suka - kodi 14310 kompenzim i përfaqësimit brenda vendit,ju thatë që deri tash ka qenë emri dreka dhe darka zyrtare,ky emër a ka ndërru si format në të gjitha komunat apo ka ndërru vetëm në komunën tone?

Fadil Hoxha - kodi është për krejt Kosovën.

Alban Berisha - Kryesues t'u kish lut që të paktën në këto pika,me gjithë respektin për z.Fadilin që e njoh si njërin prej ekspertave më të mirë të ekonomisë që e kemi dhe nuk kam dyshim në punën e tij por nuk di pse ju si ekzekutiv e keni bë zakon që zyrtari Financiar dhe zyryari ligjor të përgjigjen në pyetjet tona.Ta dimë së paku kur të vim që me zyrtarin kemi punë.Kërkoj falje prej Avniut dhe Fadilit sepse këta e kryejnë punën me krenari.Kryetari gjithmonë në pika të rëndësishme po është në një takim.Nuk jam kundër që Fadili del dhe na jep sqarime por nuk do të thotë që sa herë ka informata për buxhetin ju thoni që Fadili jep sqarime.Të lus Kryesues me qenë pak më serioz dhe ta organizoni seancën më mirë.Ta bëni një pauzë çdo një orë 5 minuta sepse nagnjëherë nuk janë as gjysma e asambleistave dhe as gjysma e drejtorave dhe po të duket vetja i ofenduar sepse s'ke për kënd me fol.

Kryesuesi - në moment që nuk ka kuorum unë e ndërpres seancën mirëpo tash kemi kuorum dhe jemi duke e vazhdu seancën dhe kur është çështja për raportin financiar,normal që Drejtori i Financave jep përgjigje dhe për secilën pikë drejtorat japin përgjigje.

Labinot Halitjaha - ne e dimë si ekzekutiv që kur të vim këtu secili e ka përgjegjësinë e vet për sektorin e vet. Ne si drejtori e kemi përgjegjësinë më të gjërë sepse e kemi punën me krejt drejtoritë por nuk mundemi me ditë çdo detaj për secilën drejtori por secila drejtori e përgadit pjesën e vet dhe jep sqarime për pjesën e vet. Po ju njoftoj që raportin e bën ZKF-ja dhe gjithmonë është më në rrjedha dhe pjesën kryesore për shpenzimin e buxhetit, format dhe mënyrën e ka ZKF sepse merret detajisht çdo ditë me Ministrinë e Financave.

Pika 8. Njoftim i Mekanizmit kundër dhunës në familje;

Kryesuesi - hap debatin.

Elmaze Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Dhuna në familje është një dukuri e ndërlikuar që ndodhet brenda marrëdhënieve familjare, afërsisë dhe më gjërë dhe ajo funksionon përmes një mekanizmi të kontrollit, frikës dhe fuqisë. Ajo është vetëm një akt fizik por përfshin edhe format psikologjike, emocionale, seksuale, ekonomike dhe sociale të abuzimit. Dhuna konsiderohet si plagë e vjetër e shoqërisë dhe njëra prej formave më të përhapura në botë dhe kësaj dukurie shqetësuese nuk i kemi shpëtuar as ne si shtet. Kur humb respekti ndaj vlerës më të madhe që kemi të qenurit njerëz, ne sot jo vetëm që po nëpërkëmben dëshirat tona por vlera edhe nderi ynë. Dhuna po vepron si kancer në shoqërinë tonë duke shkatërrur vlerat më të mira të familjes. A thua ende do të kemi frikë për fatin e nënave dhe motrave tona. Ne shqipëtarët kemi vuajtur me shekuj nga luftat, skamja dhe papunësia, pse duhet të kemi frikë tash edhe në kohë paqeje? Pse duhet të kemi frikë nga vëllezërti dhe baballarët tonë? Ata duhet të jenë mbrojtja jonë, jo dhunuesit tonë. Natyra na krijoi sëbashku por injoranca njerëzore po na ndan dhe pak kush po mendon se një grua na solli në jetë, na dha frymën, frymën të cilën ia ndalim duke e vrarë e maltretuar. Dhuna nuk atakon vetëm femrat por pjesë e dhunës mund të jenë të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara meshkuj dhe të mitur. Ne kemi nevojë për respekt e dashuri sepse dhurimi i dashurisë nuk ka kosto, është falas. Anadaj kam një kërkesë për prindërit, tu ndajmë prona vajzave sikurse djemve. Burra, regjistroni gratë e juaja bashkëpronare të pronave e bizneseve. Polici e nderuar, ti merrni më seriozisht denoncimet e grave dhe mos talleni me to. Në sferat kryesore të shoqërisë femra të mos jetë dekor e numër por të jetë faktor merit. Atëherë s' do të ketë më frikë për gratë e vajzat e reja që ende jetojnë në mëshirën e burrave, familjes, shoqërisë dhe pushtetit.

Urim Suka - unë prita që dikush nga Mekanizmi Kundër Dhunës në Familje që është i krijuar nga viti 2019 të na raportojë për këtë periudhë dhe me na dhënë krahasimin e viteve se çka ka ndodh me një vit dhe a është trendi i dhunës në familje në rënie apo në ngritje. Jo thjesht me na raportu neve si asambleist sepse ne e kemi një raport afër vetes por seanca është duke u inqizu dhe mund ta përcjellin shumë qytetarë dhe m'u informu më saktë. Në emër të LDK-së ne i japim gjithë mbështetjen këtij mekanizmi dhe jemi të interesuar që çdo rekomandim që ata kanë, nëse duhet kuvendi i komunës me dhënë mbështetje shtesë për mekanizmin për mjete financiare për m'i ju ndal ndihmë me qëllim të parandalimit të dhunës në familje, ne jemi në gjendje me dhënë gjithmonë mbështetje.

Pika 9. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kërkesës

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - si në vendimet tjera edhe ne si grup i LDK-së i japim mbështetje këtij vendimi. Unë vazhdoj të insistoj në idenë time që kjo përkrahje që jepet për secilin qytetar, nuk duhet të jepet pa një vlerësim paraprak të dëmeve nga një komision që duhet me qenë në kuadër të komunës. Mendoj që si komunë, nëse ka një komision duhet me dalë në teren dhe të bëhen vlerësimet e dëmeve dhe varësisht prej vlerësimit të dëmeve me ekzistuar një lloj përqindje sa ne mundemi m'i ndihmu x familjes.

Liridon Fandaj - edhe ne si grup e mbështesim këtë vendim apo kërkesë të personit në fjalë. Do të duhej me ditë se sa është vlera apo do të vazhdohet ashtu siq i kemi ndihmu edhe familjet tjera. Çka ka ndodh me vendimet tjera? Pse nuk janë rimbursu ose ekzekutu ato vendime pasi kam disa shqetësime nga vet personat që ende nuk i kanë dalë mjetet për dëmet që ju kanë shkaktuar.

Labinot Halitjaha - nëse është mundësia këtë përgjigje për çdo kërkesë dhe çdo vendim që e kemi marrë ta dërgoj me email për secilën çka ka ndodh sepse është çështje që duhet me pa më konkretisht dhe nuk mund të jap përgjigje ose me gabu diçka.

Aziz Bytyqi - në emër të gruptit e mbështesim këtë ndihmë. Do të ishte mirë me ardhë një vendim për me specifiku ashtu si thotë Urimi mirëpo ne kemi pas 4-5 raste dhe urojmë mos të kemi raste të tjera.

Jehona Rrafshi Lumi - në emër të partisë NISMA e mbështes këtë familje me mjete financiare dhe uroj që mos të kemi raste të tilla. Mendoj që sot t'shkojmë me këtë vlerë e pastaj të mendojmë për rastet tjera se si do ti financojmë.

Kryesuesi - shuma është 5.000€. E hedh në votim pikën 9.

Unanimisht Miratohet pika 9.

Pika 10.

Dardan Berisha - unë e propozova këtë pikë për me diskutu dhe sa i përket përgaditjes për projektvendimin është kompetencë e ekzekutivit. Nëse ka vullnet ekzekutivi për me vazhdu tutje, ne si kuvendar duhet me ia dhënë dritën e gjelbër ekzekutivit që me i fillu procedurat për këtë çështje. Kam edhe një propozim, që të gjithë shefat e grupit të asambleistave m'u ulë sëbashku dhe me bë një propozim dhe me iu drejtu ekzekutivit për me hap dritën e gjelbër për me vazhdu seancën tjetër ose kur t'është i gatshëm ekzekutivi për me sjell si projektvendim. Kërkoj sugjerim nga zyrtari ligjor se si duhet të vazhdojmë ne.

Shefket Kolgeci - mua më vjen mirë që më në fund pozita ka ardhë në pëfundim që po deshka me heq taksën komunale. Ne si grup parlamentar edhe mandatin e kaluar kemi kërku heqjen e taksës komunale dhe keni qenë të gjithë kundra dhe këtë mandat dy herë e kemi inicuar dhe keni votu kundra. Më vjen mirë që më në fund e keni pa që jeni gabim dhe e keni pa që duhet. Unë mendoj që duhet të hiqet kjo taksë dhe mendoj që sot është dashtë të vendoset mirëpo s'keni kuorum. Marrim vendim të hiqet taksa dhe skemi nevojë me i bë presion as qeverisë, as ekzekutivit por vazhdojmë.

Liridon Fandaj - cilat janë implikimet financiare në buxhet nëse ne vendosim me heq këtë taksë për veprimtaritë në biznes dhe cila është arsyeja që subjekti i tij e propozon një gjë të tillë kur ky vet ka qenë sponsoruesi i rregullores për vendosjen e këtyre taksave për aktivitetet? Atëherë është dashtë mos ta bëjnë por nëse janë duke e bë për fushatë dhe ju ka thënë Kryetari, atëherë le të vazhdojnë.

Labinot Halitjaha - kjo është kërkesë e PDK-së ku Dardani e ka shpreh kërkesën për heqjen e taksës dhe për diskutim. Kur ka qenë për votim në vitin e kaluar jemi konsultu me Dardanin se a me votu pro për heqjen e taksave. Unë si Drejtori i kam sugjeru që nuk është koha për heqjen e taksave për shkak të vendimit të qeverisë që na dha direktiva për heqjen deri në vlerë 100€ për tatim në pronë ku në vitin e kaluar Komuna rreth 500.000 deri 600.000€ ka pas me pas të hyra më pak në vitin 2024 dhe këshilla ime ka qenë që është viti jo i mirë për heqjen e taksës që ndoshta nuk mund ta mbërrijmë planifikimin. Tri vitet sa jam unë këtu si drejtor buxheti çdo herë është tejkalu mbi 300.000€, 500.000€ dhe 700.000€. Pra shihet që nuk ka me pas implikime buxhetore në kohën që jemi dhe tjetra është që shumica e komunave të Kosovës e kanë heq taksën në biznes dhe ne si komunë mund ta bëjmë këtë dhe e fundit është pjesa juaj si asambleista të vendosni çka do të ndodh me taksën në biznes. Drejtori tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - nëse komunat tjera e kanë heq taksën më herët, ti nuk është dashtë ta bësh atë rregullore sepse për atë rregullore janë shpenzu disa mjete. Mos e lidh me shpenzim të rrymës sepse e kanë më lirë se në amvisëri. Nëse i përmend vitet e kalune që kanë obligime ose ato janë të hyra, duhet ta sqarosh që nëse kalon kjo, për cilin vit po hiqet taksa?

Labinot Halitjaha - është e vërtetë që kam qenë kryetar i komisionit për taksat por aty kanë qenë të gjitha taksat komunale dhe jo vetëm taksat në biznes.

Shefket Kolgeci - kjo është puro politikë. Para zgjedhjeve po del grupi parlamentar i PDK dhe kërkon me heq taksën. Ku ishit që 7 vjet? Ka 8 vite që e kemi propozu ne dhe na keni mbivotu. Arsytimet janë të pa baza.

Selman Kolgeci - më vjen mirë që ka reflektu edhe PDK-ja që ka ardhë si sponzorizues i kësaj nisme. Normal që e pranuan që kemi qenë edhe ne dy herë këtë mandat dhe një herë mandatin e kaluar ideator dhe kemi propozu me heq taksën në biznes për shkak se rrethohemi nga komuna të cilat nuk e aplikojnë këtë taksë. Drejtori tha që nuk ka implikime shumë të mëdhaja financiare, pikërisht kjo ka qenë arsyeja pse PDK-ja e ka refuzu nismën tonë herën e kaluar. Çështja tjetër është se drejtori tha që na e kemi situatën tani më mirë. Drejtor mendoj që është e kundërta. Tash një vit i kemi pas gati 1 milion euro që i ka marrë përmbaruesi, në fund të vitit i ka marrë afër 4 milion dhe në periudhën që jemi tash i ka marrë gati 1 milion dhe po thoni që e kemi situatën më të mirë financiare. Nuk e kemi situatën më të mirë financiare por po doni me shty si PDK dhe në rregull është për ne sepse edhe herën e kaluar dhe dy herët tjera kemi qenë për me heq këtë taksë dhe i kemi dhënë arsyetimet tona. Mirë që keni reflektu tani me vonesë dhe i inkurajoj edhe AAK-në me reflektu sepse prap se prap po vini në pikat që i sjell këtu LDK-ja.

Dardan Berisha - ne jemi të gjithë të zgjedhur të qytetarëve dhe nuk mund të na ndaloj askush kush do që të jetë sponzor. Ne e kemi dhënë një sqarim kur keni këku me heq. Sa i përket kësaj pike neni 47 ligji për vetqeverisje lokale pika 47.3 e jep qartë që i merr votat apo nuk i merr votat. Sa i përket sponzorizimit e ka diskutu edhe Liridoni sa e di para jush dhe para neve. Edhe si subjekte politike dhe në bashkëpunim me shoqatën e bizneseve unë mendoj që prioritet dhe kërkesa e vetme e bizneseve është heqja e taksës komunale në aktivitet për biznese.

Urim Suka - propozoj që në procedurë të rregullt le të vjen si projektvendim në KPF, e iniciojmë dhe ne jemi të gatshëm me votu.

Avni Bytyqi - çështja e definimit të kërkesës nuk ishte shumë e qartë nga ana e Dardanit. A është lirimi nga taksa në aktivitet për vitin 2026 apo heqja e gjithë taksës në aktivitet? E përmendi Liridoni çështjen e rregullores për tarifat dhe ngarkesat që është miratu në vitin 2023 dhe që ka fillu të implementohet nga janari të vitit 2024. Nuk ka qenë vetëm Drejtori e Financave sponzorizues i asaj rregullore por ka qenë komplet ekzekutivi duke i përfshirë 10 drejtoritë. Çështja e të hyrave vetanake është e rregulluar me ligjin për Financat e Pushtetit Lokal ku konkretisht i jep autoritet dhe kompetencë komunës që të cakton taksa dhe të krijoj të hyra me qëllim që t'ju krojojë kushte sa ma të mira qytetarëve e njëra prej tyre është edhe taksa në aktivitet. Ndërsa çështja e miratimit të taksës në aktivitet është ekskluzivisht kompetencë e kuvendit që ta miratoj taksën në aktivitet dhe ta heq taksën në aktivitet. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime dhe thotë që me rregullore është miratu taksa në aktivitet dhe me rregullore duhet të hiqet kjo taksë në aktivitet dhe nga këtu le të del si kërkesë që kuvendi po kërkon nga ekzekutivi që në procedura të rregullta, brenda 2-3 muajve që ekzekutivi ta përgadit aktin me të cilën duhet ta plotëson-ndryshon rregulloren dhe ta heq taksën në aktivitet për biznese në territorin e komunës së Suharekës.

Shefket Kolgeci - çka ka të keqe që projektvendimin e sillni mbledhjen e ardhshme dhe voton Asambleja. **Avni Bytyqi** - i njejt i akt që është miratu, me të njejtin akt plotësohet dhe ndryshohet. Ne jemi duke bërë plotësim -ndryshim të rregullores dhe nuk kemi të drejtë me vendim me bërë. Ju njoftoj që të gjithë ata që kanë biznese, ta keni parasysh që kjo është një lloj konflikt interesi. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit i obligon të gjithë ata të cilët dyshojnë që mund të hyjnë në konflikt interesi, ta paraqesin para procesit të votimit apo vendim marrjes.

Urim Suka - nëse ne këtë diskutim që e bëmë deri tash e lëmë në vullnetin e ekzekutivit për me plotësu-ndryshu rregulloren, i bie që ajo mundet mos me ardhë asnjëherë. Nëse ne e marrim një vendim që e ndalim taksën në aktivitet, ky vendim e detyron ekzekutivin me bërë plotësim-ndryshimin e rregullores. Cilën do rrugë që e ndjekni, si projektvendim e kalojmë.

Pika 11. Miratimi i raportit të Komisionit për vlersimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunes.

Kryesuesi - këtë pikë ne e diskutuam. Nëse nuk ka debat, e hedh në votim.

Urim Suka - asambleistat nuk e kanë as atë raport përpara përveq shëfave të grupeve. Ne nuk jemi të obliguar me votu raportin por ne duhet me votu projektvendimin që nuk është as i shkruar. Si mundemi me votu një diçka që nuk e kemi përpara?

Avni Bytyqi - ishte dilema që Fadili dhe Avniu po japin sqarime vazhdimisht por së paku Fadili me Drejtorin e Financave i koordinojnë gjërat dhe në këtë rast Drejtori i pronës nuk është koordinu me mua dhe çështja e raportit është kështu: Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme si dhe rregullorja për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës publike i përcakton shumë qartë se si të vazhdohet me procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës publike. Deri në këtë fazë mendoj që komisioni ka vepru drejt për arsye se ju ka shpallur edhe mundësia e ankesës kur e kanë bërë vlerësimin e ofertave mirëpo së paku kur e ka procedu për kuvend lënda duhet të jetë e kompletme. Ligji për dhënie në shfrytëzim dhe rregullorja e thotë qartë, neni 21 i rregullores: nëse komisioni i ankesave e vlerëson ankesën si të pa bazuar, raporti i vlerësimit së bashku me ofertën e përzgjedhur i dërgohet kuvendit për miratim sëbashku me këto dokumenta shtesë: 1 kopje të shpalljes së njoftimit të interesit; procesverbali i hapjes së ofertave dhe raporti për vlerësimin e ofertave; rekomandimi i komisionit për përzgjedhjen e fituesit; 1 kopje e protokolluar e ofertuesit të përzgjedhur; ankesa e parashtruar nëse ka pas por në këtë rast nuk ka pas. Është dërgu raporti por nuk është dërgu edhe vendimi së bashku me këto dokumenta që i kërkon ligji ndërsa çështja e marrjes së vendimit është kompetencë e juaja.

Liridon Fandaj - kërkoja sqarim nga zyrtari ligjor për mënyrën që nëse është ligjore që me një ofertues me vazhdu.

Avni Bytyqi - ligji dhe rregullorja nuk e kërkon një gjë të tillë dhe mjafton që të jetë vetëm një ofertues.

Armend Krasniqi - ato që tha zyrtari ligjor dhe zyra ligjore e Kryetarit, absolut nuk qëndron asnjëra në përpuethshmëri, çoftë me raportin e komisionit e çoftë me drejtorinë. Komisioni e ka përfunduar të gjithë procedurën dhe ka paraqitur një raport të cilën e ka dërgu në zyrën ligjore të kryetarit, konkretisht te Kryetari pastaj zyra ligjore nuk ka qenë e përgjegjshme me e përgadit sepse ndoshta ka qenë koha jo optimale për me përgadit një raport që merr kohë 15-20 minuta mirëpo papërgjegjësinë tënde nuk duhet me gjujt dikund tjetër.

Avni Bytyqi - kur e kërkoi me fut si pikë në rendit të ditës në këtë Asamble, data e raportit është e 29.04.2025 dhe tha që punën e kemi fillu në 7 në mëngjes dhe para neve dhe para Kryesuesit nuk ka pas asgjë deri në këtë moment dhe s'kam pas si ta përgadis një projektvendim për t'ja sjell juve përpara. Mirëpo nëse ju vlerësoni dhe mendoni që çdo gjë është në rregull sipas këtij raporti që e ka sjell komisioni, votone dhe unë kur të shkoj në zyrë e hartoj vendimin.

Kryesuesi - realisht ashtu është ajo çka tha zyrtari ligjor. Unë e hedh në votim për ta tërheq nga rendi i ditës pikën 11.

9 për, 7 kundër, 2 apstenime, Tërhiqet pika 11 nga rendi i ditës

Pika 12. Pyetje dhe përgjigje;

Dardan Berisha - unë duhet ti rikthehem asaj shprehjes time të famshme që unë e kam ditë që ka me ardhë kjo situatë si çdo situatë tjetër sepse kur ti jepet fjala një asambleisti 10 herë dhe me ligj i takon një replikë dhe një herë fjala dhe të kam thënë Kryesues ta respektohet rregulloren. Ti je i pari që nuk e respekton rregulloren Kryesues i Kuvendit. Nuk mund të shesësh patriotizëm, e heki dhe s'e heki sepse kjo formë nuk më pëlqen.

Kryesuesi - forma të cilën ai e ngriti ishte plotësisht e padrejtë dhe ne deshëm ta shyejmë dhe ta miratojmë këtë vendim.

Dardan Berisha - pyetje për DSHPE, konkretisht është kërkesë e banorëve të lagjes, rrugës "Xhavit Sylja". Prej furrës "Kosovarja" dhe deri te tregu i bagëtive rruga është a pakalueshme prej gropave të mëdhaja që janë hap në atë rrugë. Drejtor është mirë ta trajtoni atë rrugë.

Enver Shabani - është e vërtetë që rruga Reqan-Budakovë është e dëmtuar sidomos pjesa e qytetit deri te rruga e Reqanit por rruga Suharekë -Reqan-Budakovë është rrugë regjionale dhe nuk na takon neve si komunë por nuk do të thotë që nuk do ta eliminojmë ndonjë gropë ku është më e vështirësune për komunikacion edhe pse kemi bërë disa ndërhyrje në disa puseta. Do të përpiqemi si komunë. E kemi një kontratë për sanimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe do ta bëj njëkërkesë te menaxheri i kontratës.

Dardan Berisha - nëse i shohim në këtë formë rrugët regjionale, edhe rruga “Skënderbeu” dhe “Brigada 123” janë regjionale por ka qepje të asfaltit ose vendoja e disa kockave për m’i eliminu ato gropa. Pra nuk është arsye që është rrugë regjionale sepse ka shumë rrugë regjionale që janë meremetu.

Jehona Rrafshi Lumi - kryesues, kërkoj që kërkesën time ta adresosh te DSHMS. Gjatë një vizite në QKMF-në në fshatin Leshan kam konstatuar që është një gjendje jo e mirë ku ambientet e brendshme janë të mbushur me myk, gjithëashtu mungojnë paisjet higjienike. Madje në këtë QMF nuk ka as gjoker dhe ato pak paisje që janë, janë blerë nga infermierja e atij vendi. Gjithëashtu është ndërprerë edhe uji për shkak të mykut që paraqet në këtë ambulant. Kjo situatë paraqet rrezik edhe për qytetarët dhe punëtorët që janë aty dhe kërkoj nga Drejtoria e Shëndetësisë ta bëjnë një inspektim dhe të marrin masa për rregullimin e këtyre problemeve.

Liridon Fandaj - kam pyetje për Drejtoreshën e Shëndetësisë ku ajo ka një kohë që nuk merr pjesë. Zëvendës drejtori i QKMF-së vitin e kaluar ka shku në lutje të mëngjesit në Amerikë dhe ka shpenzuar 5.000 € nga fondi i DSHMS. Cila ka qenë arsyeja dhe çka ka përfitu komuna nga kjo vizitë? Të njëjtën pyetje e kam edhe për Drejtorin e Urbanizmit sepse edhe ai ka shkuar në lutje të mëngjesit. Cili është përfitimi i shpenzimit të parasë publike me shku në vizitë nga një ftesë e një kompanie private sepse nuk është që ka përfitu komuna. Pyetje për DSHPE që nuk e di a është kompetentë për rrugën “Skënderbeu”. A janë të parapara në projekt kyçjet, hyrje-daljet nga krahu i djathtë në të majtë ose nga i majti në të djathtë?

Enver Shabani - DSHPE është njesi e kërkesës për rrugën që tani është pothuaj në përfundim. Nuk je i pari që po ankohesh ose që po pyet për këto kyçje që janë 3 kyçje. Sipas menaxherit të kontratës aty janë tri kyçje me projekt. Para dy javësh bashkë me një ekspert të trafikut kemi dal në teren dhe i kemi shenjëzuar shenjat e këmbësorëve por edhe sot ka probleme dhe pakënaqësi te qytetarët. Së shpejti do të shtrohet edhe faza e dytë e asfaltit. Projektanti është nga Suhareka dhe mund të bisedoni drejtpërsëdrejti ose edhe në formë zyrtare mundeni me kërk që me pas çasje në projekt sepse çdo gjë është transparente.

Liridon Fandaj - çështjen që e ngrita unë është vetëm për shkak të rrezikut të komunikacionit dhe desha të di a janë në projekt aty apo për interes të dikujt janë lënë ato kyçje sepse çdo moment aty krijohet një rrezik për me ndodh një aksident.

Enver Shabani - ke të drejtë dhe nuk është shqetësim vetëm i yti. Njëra nga arsyet që tani po diskutohet është se projekti është bërë para planit të mobilitetit dhe sa i përket planit të mobilitetit që tani është projekt i përfunduar, ky plan parash mbylljen e kyçjeve. Menaxheri i kontratës thotë që nuk ka të drejtë të bëjë devijim të projektit por me Planin e Mobilitetit do të mbyllet.

Urim Suka - Me datat 6,7 dhe 8 prill kemi pas reshje të borës dhe temperatura të ulëta, ngrica ku për pasojë dëme të konsiderueshme në këto kultura bujqësore: kumbulla, kojsi, qershi, pjeshkë dhe arra. Pyetja ime për Drejtorin e Bujqësisë: A jeni në dijeni për këto dëme? A keni komision në nivel komunal për vlerësimin e dëmeve? Nëse po, kërkoj nga ju që në afat të shpejt të bëni vlerësimin e këtyre dëmeve dhe t’u dilni në ndihmë fermerëve sipas mundësive buxhetore të komunës por edhe të kërkon mbështetje nga ministria që dëmet që i janë shkaktuar fermerëve e që janë të mëdha, sa do pak t’u kompenzohen. Së fundmi unë jam njoftu që komuna e Rahovecit veq ka fillu me i dalë ndihmë fermerëve për të njëjtat dëme andaj një gjë të tillë kërkoj që ta bëjë dhe Komuna jonë. Pyetja e dytë ka të bëjë me këshillat e fshatrave. Ne i kemi zgjedh kryetarët e këshillave të fshatrave dhe nuk e di sa është duke funksionu mirë dhe nuk më duket që si ekzekutiv jeni duke i përfill në nivelin e dëshiruar kryetarët e fshatrave. Ajo që dua të di është që ta kem nga Drejtoria e Administratës një raport prej se është themelur këshilli, sa takime janë mbajtur për vitin 2023 dhe me këshillat e fshatrave, kush kanë qenë prezent dhe sa janë pagu brenda një viti kalendarik. Kjo le të vlen edhe për vitin 2024 sepse kam vërejtje që nuk janë pagu mjaftueshëm dhe po dua t’i dal në ndihmë. Dëshiroj që raporti të vjen mbledhjen e ardhshme.

Selman Kolgeci - kemi diskutu një herë për kanalizimin në fshatin Vraniq, atë që e keni proklamuar si kanalizim i jashtëzakonshëm që po bëhet me një projekt të veçantë dhe mandej keni ardhë këtu dhe e keni pranuar që ka dështu ai kanalizim. Bëhet fjalë për kanalizimin prej Matoshve e Loshve e deri në gjysmën e fshatit. Ai projekt ka kushtuar rreth 70-80 mijë euro. Sot po i kërkoj dy gjëra për atë temë. Përgjegjësi prej juve që keni dështu dhe kur do të rregullohet ai kanalizim. E di që kompanisë i ka kalu garancioni i defekteve dhe ju nuk keni ndërmarrë asnjë gjë për atë dështim të kanalizimit. Çështja tjetër është te rruga

“Skënderbeu” dhe ka katër apo pesë seanca që kërkoj të di a keni bërë auditim të sigurisë për atë pjesë të rrugës?Një herë keni thënë që nuk e keni bërë,herën tjetër keni thënë që nuk është kompetencë e jona.Është pikërisht kompetencë e juaja dhe unë nuk mund të shkoj si asambleis ta bëj auditimin e sigurisë në atë rrugë.Ju kam paralajmëru që kanë me ndodh aksidente dhe aksidentet kanë ndodh por nuk keni ndërmarrë asgjë.Aktualisht janë 4 hymje dhe duhet auditimi dhe raportin e një eksperti të komunikacionit se a lejohen 4 kyçje në distancën 600-700m.Çështje tjetër është se a lejohen kthime majtas dhe a ka pas nevojë m'u bërë 2.6 m ishulli qëndror.E kuptoj që ishulli qëndror është i mirë kur ka hapësira por ti e ke eliminuar trotuarin për me bërë një shirit që i konvenon dikujt aty me hy dhe me dal.Këtu nuk jemi për individ por jemi për të gjithë dhe aty nesër mundet me pësuar secili qytetar.Kur kyqetarin e kam pyetur se a ka filluar implementimi i rekomandimeve të Planit të Mobilitetit,ai më ka thënë që ka filluar në shesh dhe në rrugën Skënderbeu por pikërisht atëherë s'ka pas çka me bërë kur ka filluar dhe sot rekomandimet që i kanë nxjerr ekspertat më të mirë,që i ka nxjerr raportin e auditimit,sot ato rekomandime nuk po doni m'i realizu.Duhet m'i realizu ose në të kundërtën silleni një raport që i kundërshton ato që ka thënë,që duhet m'i mbyll.

Enver Shabani - ju po thoni që nuk të kam kthyer përgjigje por unë t'u kam përgjigjur në këtë pyetje dhe përgjigjja paraprake ka qenë afërsisht sikurse iu përgjigjja Liridonit.Kur jam konsultuar me menaxherin e kontratës,ai më ka thënë që nuk guxojnë m'i mbyll tani sepse projekti është ashtu.Andaj kam thënë që kur projekti të përfundojë vazhdojmë me aplikimin e Planit të Mobilitetit.Unë nuk kam të drejtë të bëj auditim dhe për këtë kam pyetur dhe e kam trajtuar në detaje kërkesën tënde.Deri më tani e kam një raport me shkrim nga menaxheri.Çfarë do forme çoftë dhe si do që ta shihni të arsyeshme,ne jemi për bashkëpunim në interes të qytetarit.Sa i përket kanalizimit të Vraniqit,ka qenë një nga projektet më të mirë të mundshme të asaj kohe sepse e kemi bërë me kompani të projektimit.A është kryepuna mirë? Mbikqyrësi dhe menaxheri i kontratës ka qenë një inxhinier nga fusha përkatëse.Nuk kemi mujt me vlerësu se a është puna e kryer apo s'është por nuk kanë shkuar më 70.000€ dhe të ftoj ty dhe gjithë të tjerët që mund të japin kontribut në këtë fushë,dalim nga afër sepse aty është punuar diçka dhe e dini terrenin shumë mirë.

Selman Kolgeci - po e diskutoj një diçka që ka ndodh dhe nuk është dasht me ndodh.Ai kanalizim është paguar 80.000€ dhe ka funksionuar 0 ditë.Kush do që e ka kryer,nuk mundemi ne punëkryesit m'i faturu defekte. Unë jam i gatshëm me dal kurëdoherë në Vraniq dhe kudo me pa secilin problem sepse për këtë jemi këtu por nuk mund të fshihemi pas një dështimi.Sot ai rrjet i kanalizimit është inekzistent.Te çështja e rrugës Skënderbeu,unë po e kuptoj që po do me e zbatuar një diçka që e ka në letër mirëpo është po kjo qeverisje,është po ky Kryetar që edhe sheshin qëndror e ka devijuar dhe nuk po e lejon tash me bërë për të mirën e qytetarëve për mos me ndodh aksidente aty.Sot e kemi në dorë këtë çështje me rregulluar dhe unë po kërkoj me rregulluar.

Enver Shabani - unë personalisht nuk i iki përgjegjësisë dhe nuk e marrë unë këtë:po don ose s'po don Kryetari.Thashë që menaxheri i kontratës është përgjegjës.Drejtori tutje jep sqarime.